



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 6270 Prot.

Tiranë, më 31.08.2015

UDHËZIM

Nr. 31, datë 31.08.2015

PËR

PËRZGJEDHJEN, PAJISJEN ME TEKSTE SHKOLLORE DIGJITALE (SISTEME MËSIMORE INTERAKTIVE) NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR QË KANË LABORATORË ME TABLETA PËR INTEGRIMIN E PLATFORMËS E-LEARNING, PËR KLASAT E X-ta PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 47 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZ O J:

1. Përdorimin e teksteve shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive) në klasat e X-ta të gjimnazeve të cilët kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës e-learning.
2. Përzgjedhja e teksteve shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive) të bëhet në përputhje me procedurat e mëposhtme nga katalogu i teksteve shkollore digjitale i shpallur nga MAS, për vitin shkollor 2015-2016 i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit www.arsimi.gov.al

I. PËRZGJEDHJA E TEKSTEVE SHKOLLORE DIGJITALE (SISTEME MËSIMORE INTERAKTIVE)

I.1. Ngritja e Komisionit të Administrimit dhe detyrat e tij:

- a) Procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive) të administrohet nga Komisioni i Administrimit (KA), i përbërë nga tre anëtarë

(kryetar, sekretar dhe një anëtar). KA të zgjidhet me konsensus nga këshilli i mësuesve të shkollës. Nëse nuk arrihet konsensusi, zgjedhja bëhet me shumicë të thjeshtë të pjesëmarrësve në mbledhje.

b) Komisioni i Administrimit të kryejë këto detyra:

- Të organizojë dhe të administrojë procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive).
- Të pajisë të gjithë mësuesit e shkollave pilot që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës e-learning, me katalogun e MAS-it për tekste shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive) të vitit 2015-2016.
- Të respektojë datën, orën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes zgjedhore të teksteve shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive) brenda afatit të caktuar nga MAS-i.
- Të japë udhëzimet për të gjitha procedurat që do të ndiqen nga mësuesit.
- Të administrojë procesverbalet e mësuesve të klasave të X-ta .
- Të hartojë, mbi bazën e procesverbaleve të mësuesve, tabelën përmbledhëse për çdo shtëpi botuese, titujt e së cilës janë përzgjedhur nga mësuesit. Tabelat përmbledhëse të mbahen në tri kopje origjinale dhe të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KA-së.

I.2. Detyrat e mësuesve të klasave sipas programeve lëndore:

- a) Në çdo shkollë, mësuesit të grupohen në bazë të programeve lëndore.
- b) Mësuesit e klasave X-ta të programeve lëndore përkatëse, t'i analizojnë alternativat e teksteve shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive) dhe pas diskutimeve për to, të vendosin për tekstin shkollor digjital (sistemin mësimor interaktiv) që do të përdoret në secilën klasë/lëndë.
- c) Zgjedhja e tekstit shkollor digjital (sistemi mësimor interaktiv) të bëhet me konsensus. Në rast se mësuesit e klasave të përmbajtjeve lëndore nuk bien dakord, përzgjedhja të bëhet me votim. Fitues është teksti shkollor digjital (sistemi mësimor interaktiv) që merr shumicën e votave.
- d) Mbledhja e mësuesve të klasave të përmbajtjeve lëndore përkatëse, të bëhet e hapur për prindërit dhe median. Mësuesit të plotësojnë dhe të nënshkruajnë procesverbalet e përzgjedhjes së teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive). Procesverbalet t'i dorëzohen Komisionit të Administrimit.
- e) Mësuesi të mbajë përgjegjësi për sasinë e teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) të porositura, në mënyrë që sasia në numër të jetë deri në 95 për qind e saktë.
- f) Procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) për klasat X-ta në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës e-learning të bëhet më 7 shtator 2015.

I.3. Detyrat e drejtorit të shkollës:

- a. Drejtori i shkollës t'i përcjellë zyrtarisht çdo shtëpie botuese/subjekti një kopje origjinale të tabelës përmbledhëse përkatëse, të hartuar dhe të nënshkruar nga KA-ja, **brenda datës 8 shtator 2015**.
- b. Drejtori i shkollës të dërgojë në DAR/ZA, **brenda datës 8 shtator 2015**, tabelën përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) të përzgjedhura nga shkolla.

Drejtori i shkollës ka përgjegjësinë:

-Të njohë këshillin e mësuesve të shkollës me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit për përzgjedhjen, pajisjen me tekste shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës e-learning, për klasat e X-ta për vitin shkollor 2015-2016.

-Të sigurojë për të gjithë mësuesit e klasave X-ta në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës e-learning, katalogun e teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) për vitin 2015-2016.

Dokumentacioni që rrjedh nga zbatimi i Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ruhet në arkivin e shkollës për dy vjet dhe të jetë objekt i kontrollit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe të MAS-it.

I.4. Detyrat e njësive arsimore vendore (DAR/ZA):

DAR/ZA-ja ka për detyrë:

- a) Të njohë të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës e-learning me udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit për përzgjedhjen, pajisjen me tekste shkollore digjitale (të sistemeve mësimore interaktive) në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës e-learning, për klasat e X-ta për vitin shkollor 2015-2016.
- b) DAR/ZA-të brenda datës 6 shtator 2015, të marrin masat për prezantimin e teksteve shkollore digjitale (sistemeve mësimore interaktive), përpara mësuesve të klasave të X-ta me qëllim prezantimin e këtyre teksteve përpara fazës së përzgjedhjes, me formate prezantimi të dërguara nga MAS.
- c) Të sigurojë për të gjitha këto shkolla katalogun e teksteve shkollore digjitale (të sistemeve mësimore interaktive) për vitin 2015-2016, në formë elektronike dhe të shtypur.
- d) Të hartojë tabelën përmbledhëse të teksteve shkollore digjitale (të sistemeve mësimore interaktive) të përzgjedhura, mbi bazën e të dhënave të shkollave dhe ta dërgojë në MAS **brenda datës 10 shtator 2015**.

I.5. Monitorimi nga MAS ISHA, DAR/ZA-të

- a. MAS, ISHA, DAR/ZA-të të monitorojnë mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes së teksteve shkollore digjitale (te sistemeve mësimore interaktive); të pranojnë dhe të shqyrtojnë ankesa nga botues/subjekte dhe të verifikojnë rastet nëse mësuesve u bëhet presion apo u shkelet e drejta për përzgjedhje.
- b. MAS, ISHA, DAR/ZA-të dhe drejtuesit e shkollave të monitorojnë shpërndarjen dhe pajisjen me tekste shkollore digjitale (sistemeve mësimore interaktive).

II. KONFLIKTI I INTERESIT

1. Çdo punonjësi të MAS-it dhe të institucioneve të varësisë i ndalohet ndikimi në procesin e përzgjedhjes.
2. Titullari i DAR/ZA-së, çdo punonjës i saj dhe drejtuesit e shkollës e kanë të ndaluar të bëjnë presion apo të ndikojnë te mësuesit në përzgjedhjen e teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive). Atyre nuk u lejohet favorizimi i shtëpive botuese si dhe dallimi i teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) të veçanta në raport me të tjerat. Në rast të verifikimit të shkeljeve të sipërpërmendura, për këta nëpunës të aplikohen masa administrative deri në largim nga detyra.
3. Gjatë procesit të përzgjedhjes së teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive në shkolla nuk lejohet asnjë veprimtari e shtëpive botuese/subjekti që ka për qëllim publicitetin e teksteve shkollore të tyre.
4. Në rast se do të vërtetohet që botues/subjekte apo punonjës të shtëpive botuese ndikojnë në përzgjedhjen e teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) të tyre në shkolla, titujt e tyre do të hiqen nga Katalogu i MAS-it për tekstet shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive).

SHPËRNDARJA DHE PAISJA ME TEKSTE SHKOLLORE DIGJITALE (SISTEME MËSIMORE INTERAKTIVE

- a) Shtëpitë botuese/distributorët e teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive), të marrin masa për paraqitjen e prezantimeve për mësuesit e Klasave të X-ta në MAS, brenda datës 3 shtator 2015, për secilën përmbajtje digjitale.
- b) Për shpërndarjen dhe pajisjen me tekste shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive) janë përgjegjës botuesit/distributorët e teksteve shkollore digjitale (sisteme mësimore interaktive).
- c) DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave t'u krijojnë kushte lehtësuese shtëpive botuese/subjekteve të teksteve shkollore digjitale, njëkohësisht dhe ti monitorojnë ata për zbatimin e procesit.
- d) Përgjegjësi i sektorit të TIK dhe Statistikës në DAR/ZA të jetë personi përgjegjës (pikë kontakti) që mban lidhje të vazhdueshme me Komisionin e Vlerësimit të Teksteve Digjitale në MAS dhe të informojë çdo ditë për mbarëvajtjen e procesit deri më 19 shtator 2015.


- e) Shitja dhe shpërndarja e tekstit shkollor digjital në shkolla, të përfundojë **më datë 19 shtator 2015**, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi.
- f) Ndaj subjekteve, botuesve ose distributorëve që nuk zbatojnë rregullin e mësipërm, të aplikohen masat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
- g) DAR/ZA të raportojnë në MAS çdo ditë, në mënyrë të vazhdueshme, për porositjen dhe blerjen e teksteve shkollore digjitale.

VI. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore, shkollat dhe mësuesit.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR